



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 386/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur më 11.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3900 (tremijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, më datë 08.12.2010 në orën 19:45 në rrugën “Luan Haradinaj” në Prishtinë duke i mbuluar posterin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja, me posterin e kandidatit të tyre për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Hajrullah Tërnavë.

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja të cilës ia kanë bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidatit Hajrullah Tërnavë nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar për të sqaruar se a ka bërë përpjekje për të parandaluar simpatizantët për mos bërë shkeljen e kodin e mirësjelljes.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës Hajrullah Tërnavë, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja. PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Prandaj nga arsytet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 386/2010 më datën 11.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

